




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 21 paragrafi (4), në mbledhjen e mbajtur me datë 21.12.2023, miraton:

STATUTIN E
AUTORITETIT TË KONKURRENCËS TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Statut rregullohet organizimi dhe funksionimi i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës (në vazhdim Autoriteti).

Neni 2

Statusi i Autoritetit

Autoriteti është agjenci e pavarur, që në mënyrë të pavarur kryen detyrat e veta në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës, që është edhe themelues i Autoritetit.

Neni 3

Emërtimi

1. Emri i plotë i Autoritetit është Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës i shprehur edhe në gjuhët serbisht dhe anglisht, me shkurtesat respektive.
2. Në të gjitha dokumentet e Autoritetit do të jetë emërtimi zyrtar:
 - 2.1. Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës – AKRK.
 - 2.2. Autoritet za Konkurenciju Republike Kosovo – AKRK.
 - 2.3. The Competition Authority of the Republic of Kosovo – CARK.

Neni 4

Selia

Selia e Autoritetit është në Prishtinë.

Neni 5

Vulat

1. Autoriteti ka një vulë rrethore dhe një vulë katërkëndëshe.

1.1. Vula rrethore

Vula rrethore e Autoritetit ka diameter 40mm, është me disa rrathë koncentrik, shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit dhe përmban këto të dhëna:

- në rrethin e parë të jashtëm shkruhet: REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO.
- në rrethin e dytë: AUTORITETI I KONKURRENCËS.

- në rrethin e tretë: AUTORITET ZA KONKURENCIJU.
- në rrethin e katërt: COMPETITION AUTHORITY.
- në sipërfaqen e mbetur brenda rrethit të vulës vendoset: STEMA e Kosovës.
- nën stemë shkruhet: PRISHTINË/A.

1.2. Vula katërkëndëshe

Vula katërkëndëshe e Autoritetit e cila përdoret për protokollimin e shkresave, ka dimensionin 35mm me 70mm dhe përmban këto të dhëna sipas renditjes:

- në pjesën e epërme të vulës, në anën e majtë vendoset STEMA e Kosovës, në anën e djathtë vendoset LLOGO e Autoritetit dhe në mes tyre shkruhet si në vijim:
- rreshti i parë: REPUBLIKA E KOSOVËS.
- rreshti i dytë: REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO.
- rreshti i tretë: AUTORITETI I KONKURRENCËS.
- rreshti i katërt: AUTORITET ZA KONKURENCIJU-COMPETITION AUTHORITY.
- rreshti i pestë (nën stemë): hapësira ku do të shënohet numri i protokollit të shkresës.
- rreshti i gjashtë: hapësira ku do të shënohet numri i faqeve të bashkangjitura.
- rreshti i shtatë: hapësira ku do të shënohet dita, muaji dhe viti.
- rreshti i tetë: PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINE.

2. Porositja, përdorimi dhe ndërrimi i vulave bëhet në mënyrën e përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

3. Për ruajtjen dhe përdorimin e drejtë të vulave përgjegjës është Asistenti administrativ i Kryetarit të Autoritetit.

Neni 6

Veprimtaria administrative

Autoriteti kryen veprimtari administrative dhe profesionale lidhur me mbrojtjen e konkurrencës, duke zbatuar rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Neni 7

Punët administrative

1. Autoriteti kryen punë administrative, sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe legjislacionit tjetër përkatës:

- 1.1. Vlerëson pajtueshmërinë e marrëveshjeve me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës:
- 1.2. Përcakton përjashtimin e marrëveshjeve.
- 1.3. Përcakton abuzimin e pozitës dominuese.
- 1.4. Vlerëson për lejimin e përqendrimit dhe shfuqizon ose ndryshon vendimin për lejimin e përqendrimit.
- 1.5. Përcakton masa të përkohshme.
- 1.6. Anulon, shfuqizon ose ndryshon vendimin të cilin e ka marrë për përjashtimin e marrëveshjeve.
- 1.7. Përcakton masat për të siguruar konkurrencë efektive dhe afatet e ekzekutimit të tyre në rast të përqendrimit të palejuar.

Neni 8

Punët profesionale

1. Autoriteti kryen punë profesionale në bazë të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe legjislacionit tjetër përkatës dhe në veçanti:

- 1.1. Ofron opinione profesionale mbi përputhshmërinë e projektligjeve dhe rregulloreve tjera me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, si dhe çështje të tjera që mund të ndikojnë ndjeshëm në konkurrencë.
- 1.2. Shqyrton dhe propozon baza metodologjike për hulumtimin e konkurrencës në treg.
- 1.3. Mbledh të dhëna dhe informacione nga ndërmarrjet, të cilat janë thelbësore për hulumtimin e tregut dhe përcaktimin e gjendjes në treg, pavarësisht nga veprimet konkrete që zhvillon Autoriteti.
- 1.4. Ofron sugjerime për përmirësimin e konkurrencës lojale.
- 1.5. Ofron mendime profesionale dhe rekomandime me vetëiniciativë ose me kërkesë të organeve publike.
- 1.5. Përgatitë punët e bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me ekzekutimin e detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës, të deleguara në Autoritetin e Konkurrencës, respektivisht bashkëpunon me autoritetet tjera ndërkombëtare të autorizuar për mbrojtjen e konkurrencës, organizata ndërkombëtare dhe institucione.
- 1.6. Bashkëpunon me institucionet simotra lidhur me fushëveprimin e Autoritetit, të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.
- 1.7. Bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e buxhetit, në përputhje me ligjet në fuqi.
- 1.8. Harton raportin vjetor të punës edhe e publikon atë në faqen zyrtare të Autoritetit.

Neni 9

Raporti vjetor

1. Autoriteti i paraqet raport vjetor Kuvendit të Republikës së Kosovës i cili përmban:
 - 1.1. Kërkesat e paraqitura dhe procedurat e filluara për përcaktimin e çrregullimit të konkurrencës së lirë.
 - 1.2. Konstatimin e shkeljeve të dispozitave për mbrojtjen e konkurrencës.
 - 1.3. Vlerësimin e marrëveshjeve, konfirmimin e abuzimit me pozitën dominuese dhe vlerësimin e përqendrimeve të ndërmarrjeve mbi masat e marra për mbrojtjen e konkurrencës.
 - 1.4. Bashkëpunimin me Insitucionet vendore që ka të bëjë me dhënien e mendimeve profesionale si dhe përfaqësimin në Insitucionet ndërkombëtare që ndërlidhen me mbrojtjen e konkurrencës.
2. Raporti nga paragrafi 1 i këtij neni përmban edhe një pasqyrë mbi gjendjen e përgjithshme të konkurrencës në Republikën e Kosovës, mendime, vlerësime dhe sugjerime për përmirësimin e konkurrencës si dhe propozime e vlerësime që ndërlidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Neni 10

Struktura e brendshme

1. Autoriteti përbëhet nga:
 - 1.1. Komisioni dhe
 - 1.2. Sekretariati.
2. Komisioni miraton Rregulloren e punës së Komisionit të Autoritetit dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit të Autoritetit.
3. Kryetari, Nënkryetari dhe anëtarët e Komisionit kanë statusin e funksionarit publik dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa nëpunësit e Sekretariatit kanë statusin e nëpunësit të shërbyesit civil dhe zgjidhen e emërohen sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin për zyrtarët publik dhe Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

Neni 11

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës

Komisioni është organ kolegjal që menaxhon me punën e Autoritetit. Komisioni përbëhet nga pesë (5) anëtarë, duke përfshirë Kryetarin dhe Nënkryetarin, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, siç parashihet në Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

Neni 12

Kompetencat e Komisionit

1. Përgjegjësitë e Komisionit lidhur me legjislacionin:

1.1. Miraton Statutin.

1.2. Harton dhe miraton akte nënligjore për zbatim të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

1.3. Harton dhe miraton aktet nënligjore për punën e Komisionit të Autoritetit dhe të organizimit të Sekretariatit të Autoritetit.

1.4. Propozon metodologjitë për hulumtimin e marrëveshjeve të ndaluara, pozitive dominuese, përqendrimin e ndërmarrjeve apo fenomeneve të tjera që cenojnë konkurrencën e ndershme.

1.5. Miraton procedurat e aplikimit për lejimin apo përjashtimin e marrëveshjeve të caktuara.

1.6. Miraton kriteret mbi bazën e të cilave do të gjykohet për lejimin apo përjashtimin si edhe formularët/aplikimet që duhet të plotësojnë të interesuarit.

2. Përgjegjësitë e Komisionit lidhur me politikën e konkurrencës:

2.1. Propozon politika për nxitjen e konkurrencës së lirë dhe të ndershme.

2.2. Bashkëpunon me organizata dhe institucione lokale dhe ndërkombëtare për të përmirësuar dhe forcuar Autoritetin dhe punën e tij.

2.3. Informon dhe ndërgjegjëson publikun për konkurrencën në treg.

2.4. Kryen studime të tregut dhe avokon në lidhje me konkurrencën.

3. Përgjegjësitë e Komisionit lidhur me procedurat hetimore:

3.1. Inicion hetimin kur ka dyshime për cenim të konkurrencës apo të ekzistencës së ndonjë fenomeni që ndalohej me ligj.

3.2. Udhëzon departamentet dhe personelin përkatës për zhvillimin sa më efikas të hetimeve në përputhje me Ligjin dhe me rregulloret e vendimet e brendshme.

3.3. Merr vendime sipas afateve në procedurat e nisura bazuar në faktet dhe konkluzionet e hetimit.

3.4. Mbikqyrë zbatimin e vendimeve të veta.

4. Përgjegjësitë e Komisionit lidhur me menaxhimin:

4.1. Emëron dhe shkarkon Drejtorin e Përgjithshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me propozim të Kryetarit të Autoritetit.

4.2. Udhëzon Departamentet dhe personelin përkatës, përmes Drejtorit të Përgjithshëm për detyrat dhe kompetencat specifike.

4.3. Deleton detyra administrative te Drejtori i Përgjithshëm.

4.4. Veprimet lidhur me personelin e Autoritetit vlejné dispozitat e Ligjit për Zyrarët Publik.

5. Përgjegjësitë e Komisionit lidhur me buxhetin:

5.1. Miraton projektbuxhetin që i propozohet Qeverisë së Republikës së Kosovës.

6. Kryen veprimtari, punë dhe detyra tjera të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

Neni 13

Kryetari, Nënkryetari dhe anëtarët e Komisionit

1. Kryetari i Autoritetit është përgjegjës për aktivitetin dhe punën e Autoritetit:
 - 1.1. Përfaqëson Autoritetin dhe menaxhon me punën e tij.
 - 1.2. Përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet e Komisionit qoftë ato të planifikuara apo të jashtëzakonshme.
 - 1.3. Bashkërendon punën ndërmjet anëtarëve të Komisionit.
 - 1.4. Përfaqëson Autoritetin në marrëdhënie me të tretët.
 - 1.5. Nënshkruan aktet e Komisionit, me përjashtim të vendimeve që nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Komisionit.
 - 1.6. Përgjigjet për punën profesionale të Autoritetit.
2. Në rast mungese, Kryetarin e zëvendëson Nënkryetari ose i autorizuari i Komisionit.
3. Rregullorja e punës së Komisionit parashikon detyrat specifike dhe procedurat e plotësimit të tyre nga secili anëtar i Komisionit.

Neni 14

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit

1. Drejtori i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi:
 - 1.1. Drejton dhe bashkërendon punën administrative të Sekretariatit.
 - 1.2. Siguron hartimin dhe paraqitjen e raportit të hetimit për vendimmarrje në Komision.
 - 1.3. Në bashkëpunim me Departamentet dhe Divizionet e Sekretariatit ndjek zbatimin e rregullores së brendshme të Sekretariatit dhe zbatimin e vendimeve të Komisionit.
 - 1.4. Harton raportin vjetor të punës së Autoritetit.
 - 1.5. Njofton Komisionin përkatës të Kuvendit dhe Qeverinë jo më vonë se gjashtë (6) muaj përpara përfundimit të mandatit të secilit prej anëtarëve të Komisionit të Autoritetit, me qëllim që Qeveria dhe Kuvendi të fillojnë procedurat për zgjedhjen dhe emërimin brenda përfundimit të mandatit.

Neni 15

Konflikti i interesit

1. Konflikti i interesit rregullohet me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës.
2. Cilido anëtar i Komisionit dhe nëpunës i Sekretariatit që për çfarëdo arsye ka interesa apo lidhje të çfarëdo natyre me ndonjë person juridik apo fizik nën hetim apo disponon informacion të marrë në çfarëdo lloj mënyre duhet t'i paraqesë ato gjatë mbledhjeve përkatëse të Komisionit dhe të mos marrë pjesë në votimin e vendimit përkatës.

Neni 16

Fshehtësia afariste

1. Autoriteti konsideron fshehtësi afariste atë informacion, dokument të çfarëdo lloj forme sipas kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni në Kosovë apo nga çdo person fizik e juridik sipas veprimtarisë së tyre dhe në përputhje me legjislacionin përkatës.
2. Të gjithë punonjësit e Autoritetit janë të detyruar të ruajnë sekretin zyrtar. Ky detyrim vlen edhe për personat e tjerë që për shkak të marrëdhënies së tyre me Autoritetin janë vënë në dijeni të sekreteve zyrtare që disponon Autoriteti.
3. Publikimet e Autoritetit nuk duhet të përmbajnë të dhëna që përbëjnë sekret zyrtar.

Neni 17

Transparenca në punë

Autoriteti siguron transparencën duke bashkëpunuar me media dhe institucionet tjera me raportimin për aktivitetet dhe veprimtarinë e Autoritetit për të cilën vendos Komisioni.

Neni 18

Botimi në Gazetën Zyrtare dhe informimi publik

1. Autoriteti publikon në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës aktet nënligjore dhe vendimet në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.
2. Autoriteti gjithashtu në faqen e vet elektronike publikon aktet nënligjore, aktet tjera juridike, vendimet dhe botimet periodike, sipas rregullave të brendshme të Autoritetit.

Neni 19

Ndryshimi dhe Plotësimi i Statutit

1. Kryetari, Nënkyetari dhe anëtarët e Komisionit kanë të drejtë në çdo kohë të propozojnë ndryshime dhe plotësime të Statutit.
2. Procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit është e njëjtë me atë të miratimit të tij.

Neni 20

Hyrja ne fuqi

Ky Statut hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës



Neime Binaku-Isufi